VENDIM
Nr. 834, datë 28.10.2020

PËR TRANSFERIMIN, NË PRONËSI TË BASHKISË GJIROKASTËR, TË NJËSISË ADMINISTRATIVE GJIROKASTËR, TË PASURISË 7/6-N3, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 8541

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja "a", 5 e 8, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin, në pronësi të Bashkisë Gjirokastër, të njësisë administrative Gjirokastër, të pasurisë 7/6-N3, të llojit "Njësi", me vendndodhje në zonën kadastrale 8541, sipas formularit (gjithsej, 1 (një) fletë) e planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për t'u përdorur në fushën administrative.
2. Bashkisë Gjirokastër i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përdorimit, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve pasurinë e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.
3. Ngarkohen Bashkia Gjirokastër dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

3.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

Njësia Administrative : **Gjirokastër**

Aprovoi: **Flamur Golemi** (Këshilli Bashkie)

(emri, mbiemri, drejtuesi zyrtar, tel., firma, vula)

Fusha e perdorimit te Prones: **Administratë**

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndërtese (m2)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjesi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
51	8541 F - 8	7/6-N3	Njësi	Sigurimet shoqërore + Dhoma e Tregëtisë Bashkia Gjirokastër		352,3	Zyra	Bashkia Gjirokastër	Bashkia Gjirokastër	Subjekti ndodhet në katin II (në gjuhë teknike) te godinës së Sigurimeve Shoqërore

PLANIMETRIA E



Sip. ndertimi 352.